



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI, PËR MBIKQYRJEN E
ZBATIMIT TË LIGJIT PËR MINIERAT DHE MINERALET
TË MBAJTUR MË 21.09.2016**

SHTATOR
2016

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

SALA BERISHA-SHALA (KRYESUESJA): Mirëmëngjesi të gjithëve.

Përshëndetje për juve të gjithë pjesëmarrës,

Përfaqësues të institucioneve shtetërore, ndërmarrjeve publike, kompanive private që merren me operimin e minerareve, përfaqësues të Fakultetit të Gjeoshkencave në Mitrovicë,

Përshëndetje për ju media,

Shoqëritë civile dhe gjithë ju të pranishëm,

Sot pra kemi dëgjimin publik në lidhje me Ligjin për miniera dhe minerale.

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti Industri dhe Infrastrukturë në kuadër të planit të vetë të punës për këtë vit ka parapa që të monitoroj Ligjin për miniera dhe minerale të lihet se sa po zbatohet, ku janë pengesat, ku janë vështirësitë.

Komisioni Parlamentar menjëherë masë bërjes së ligjeve ka për obligim jo vetëm Komisioni por të gjithë deputetët e kanë për obligim të shohin se ato ligje që i nxjerr Kuvendi i Kosovës të monitorohen, të shihen se sa po zbatohen dhe në bashkëpunim me akterët e zbatimit të këtyre ligjeve dhe të gjithë të tjerët që prekin nga këto ligje të shihet se cila është shkallë e zbatimit, ku janë pengesat, ku janë vështirësitë. Prandaj, organizon monitorime, dëgjime publike në mënyrë që bashkërisht me ju të shohim të bëjmë më të mirën të mundshme.

Ne jemi mundua që t'i ftojmë të gjithë ata të cilët drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me këtë ligj, t'i ftojmë në dëgjim publik.

Ftesa dhe lajmërimi ka qenë edhe në web faqet e Kuvendit në mënyrë publike dhe për të gjithë të tjerët të cilët nuk kanë arrit të marrin materialin përmes postës elektronike nga administrata që e mbështetë Komisionin Parlamentar.

Ju i keni marrë materialet, i keni marrë dhe disa pika të cilat ne jemi mundua që ju duhet sot t'i japni kontributin e juaj përmes debatit në këtë dëgjim publik.

Shumë shkurt më lejoni që t'i përmend edhe një herë ato pika të cilat ne i kem nxjerr në bashkëpunim me administratën që e mbështetë Komisionin Parlamentar dhe kemi identifikuar çështje që duhet trajtua, sqarua apo propozua zgjidhje si në vijim.

Cilat akte nënligjore janë nxjerr deri më tani dhe a kanë mbet diçka që duhet të nxirren, cilat raste mund të trajtohen si vakume juridike, si është veprua në këto raste. Unë jam e bindur që ne gjithmonë me biseda me jua zyrtare e jo zyrtare kemi përmend shpeshherë se ka vakume ligjore të cilat shpesh kanë mbet të pa zgjidhura sidomos me kompanitë që kanë investua në sferën e operimeve minerare.

Cila segmente ka pasur ngecje dhe cilat janë faktorët ndikues, faktorët mund të jenë të natyrave të ndryshme, faktorë politikë, neve na intereson më tepër si Komision për faktorët juridikë apo ka edhe ndonjë faktor teknik për zbatimin e këtij ligji.

Cilat mendoni se do të ishin masat preventive për përmirësimin në zbatim të plotë të këtij ligji, cili është komunikimi institucional në frymën e këtij ligji. Sigurisht që institucionet që direkt merren me zbatimin e ligjit siç është Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale por edhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik, kanë marrë vërejtje, kanë marrë dhe opinione nga kompanitë dhe bizneset për nivelin e zbatimit të këtij ligji.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerare a ka kapacitete të mjaftueshme të plota për zbatimin e këtij ligji, kur flasim për kapacitetin është fjala për kapacitete edhe njerëzore edhe sigurisht edhe hapësira të punës edhe ndonjë kapacitet tjetër që ju e vlerësoni.

Çfarë veprimesh mendoni që duhet të merr Komisioni, Kuvendi për të bërë të mundur zbatimin e ligjit. Ka edhe çështje tjera të cilat ndoshta ne nuk kemi arritur të identifikojmë por shpresoj që sot në këtë debat të përbashkët do ta dalin edhe çështje tjera të cilat juve ju preokupojnë dhe mbi të gjitha monitorimi i zbatimit të ligjit e ka për detyrë që të shoh në qoftë se ka ndonjë zbrastirë ligjore t'i hyjmë bashkë plotësimit dhe ndryshimit të ligjit.

Natyrisht se Kosova po ecë përpara edhe ligjet tjera por edhe ky ligj ka nevojë të plotësohet dhe të ndryshohet edhe konformë standardeve evropiane por edhe konform situatës të cilën po kalon Kosova në këtë kohë.

Besoj që jeni mendimit edhe ju me mua se Kosova ka pasuri të mëdha minerare të cilat ende nuk kemi arrit që t'i përkthejmë në zhvillim ekonomik.

Prandaj, ky angazhim i përbashkët na jep mundësinë bashkërisht që së pari infrastruktura ligjore të jetë ajo e duhur e nivelit të duhur që pastaj më tutje t'i

kemi më lehtë që këto pasuri të cilat i posedojmë të shkojnë me hapjen e vendeve të reja të punës, natyrisht të ndihmojë edhe zhvillimin ekonomik të Kosovës.

Ne nuk e kemi bërë ndonjë agjendë se cili me marrë fjalën me radhë, por dëshiroj që secili që e merreni fjalën të prezantoheni dhe çka përfaqësoni, ndërmarrje publike apo biznese private apo institucione.

Sot fjala është e juaja, ne si deputet kemi për obligim me ju dëgjua juve, ju bashkërisht me i ballafaqua çështjet të cilat mendoni që duhet të zgjidhen me ligj apo t'i ballafaqoni edhe opinionet për kontra besoj që ju gjithë njëjtë mendoni për çështje të caktuara të cilat janë për momentin në ligj.

Faleminderit, shumë për pjesëmarrjen e juaj, për kohën që e keni nda bashkërisht me ne, do të jemi vazhdimisht me ju jo vetëm sot në dëgjim publik por vazhdimisht ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës ju mos hezitoni të na kontaktoni për çfarëdo çështje, probleme, arsye që mendoni që ne mund ta zgjedhim si përfaqësues të juaj. Fjala është e juaja, kush dëshiron me marrë fjalën?

MUSA SHABANI: Përshëndetje për të gjithë,

E nderuar deputete Sala,

I nderuari deputeti Qela,

Të nderuara përfaqësues të institucioneve,

Përfaqësues të biznesit,

Përfaqësues të mediave,

Dhe të gjithë ju të pranishëm,

Unë jam Musa Shabani, kryesues i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerare edhe jemi Agjenci e Pavarur e cila i raportojmë pikërisht Komisionit për Zhvillim Ekonomik të Kuvendit të Kosovës dhe jemi agjencia e cila jemi direkt në zbatimin dhe i bartin përgjegjësitë e zbatimit të këtij ligji.

Fillimisht dua të ju theksoj se Ligji për miniera dhe minerare është miratuar për herë të parë në vitin 2010 dhe është Ligji 03/L-163 i cili është plotësua dhe ndryshua në vitin 2013 me Ligjin 04/L-158.

Natyrisht se të gjitha ligjet duhet t'i përmbushin disa objektiva të cilat janë kryesore që të ofrojnë, si e para objektivi i parë i ligjit ka qenë të ofroj barazi për zhvillimin e biznesit në fushën e hulumtimit, shfrytëzimit dhe përpunimit të minerareve në Republikën e Kosovës si dhe të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit, të ketë kritere që garantojnë sigurinë dhe interesin e qytetarëve

dhe të shtetit të Republikës së Kosovës dhe të jetë konkurruese dhe më i favorshëm se ligjet tjera të kësaj fushe ose të mineraleve në rajon.

Por gjithashtu ligji duhet t'i plotësoj edhe kriteret që dalin nga direktivat e Bashkimit Evropian dhe standardeve ndërkombëtare.

Ne gjatë zbatimit të ligjit ka disa mangësi dhe i kemi ngritë si çështje edhe në diskutim me deputetët e Parlamentit të Kosovës, gjithashtu edhe në Qeverinë e Republikës së Kosovës respektivisht në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe ato çështje që ne i kemi identifikua dhe që kemi mendua se duhet t'i përfshijmë në plotësimin dhe ndryshimin e radhës së ligjit janë.

Harmonizimi i Ligjit të minierave dhe mineraleve me ligje të tjera sidomos me Ligjin për tokat bujqësore dhe Ligjin për pyjet e Kosovës, sepse këtu kemi një mosharmonizim apo kemi kolizion ligjor tek sipërfaqet e lejuara të shfrytëzimit dhe kohëzgjatja e pëlqimeve tek Agjencioni i Pyjeve të Kosovës ku sipërfaqet me Ligjin për miniera dhe minerale lejohen sipërfaqe më të mëdha të shfrytëzimit derisa Ligji për pyjet këto i kufizon deri në 5 hektarë.

Po ashtu edhe kohëzgjatja e pëlqimeve te Agjencioni i Pyjeve të Kosovës është për 5 vite, kurse Ligji për miniera e minerale e parasheh që një licencë e shfrytëzimit mund të jetë aq sa ka rezerva o ... minerale na atë vendburim dhe çfarë kapacitete të prodhimit janë të projektuara për shfrytëzimin e atij vendburimi dhe që mund të zgjat deri në 25 vite. Me të drejtë të vazhdimin të operimeve për 25 vite të tjera. Domethënë këtu ka mospërputhje mes këtyre dy ligjeve.

Madje, çështje tjetër është çështja që e kemi pasur, paraqet problem sidomos tek bizneset dhe po ashtu nuk është në përputhje me standardet e Republikës së Kosovës, është garancione për rikultivimin apo mbylljen e minierave pas shfrytëzimit. Këto janë garancionet që janë paraparë me Ligjin për miniera dhe minerale, kërkojnë sipas një standardi me 3a që duhet të bëhen në bankat cilat i kanë 3a faktikisht i kanë një standard që nuk ekziston në Kosovë, që asnjë bankë në Kosovë nuk është me 3a.

Çështje tjetër, te garancionet po ashtu është edhe një problem që kam paraqitë bizneset, për arsye se garancioni u merret kompanive në fillim ende pa fillua punën dhe kjo po paraqet një bar pronë për investimet sidomos te kompanit e vogla dhe të mesme, për arsye se në vend që ato para t'i fusin në investime dhe direkt në makineri për shfrytëzim të minierave edhe zhvillim të kapaciteteve prodhuese ato

detyrohen fillimisht që të bëjnë një garancion të cilat kapen vlera goxha të mëdha varësisht nga sipërfaqja që e shfrytëzon.

Ne kemi mendua që edhe kjo çështje duhet të adresohet në ligj dhe të rregullohet përvoja më të mira të rajonit dhe ndërkombëtare.

Mandej është një çështje tjetër, e kemi çështjen e operimeve legale. KPM-ja ka mekanizma për zbatimin e Ligjit përveç mekanizmave që janë ligjor edhe mekanizmave që administrojnë licencat dhe gjithë procesin, kemi edhe inspektoratin në kuadër të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale i cili përveç që merret me përcjelljen e zbatimit të projekteve të shfrytëzimit apo të licencave të lëshuara nga KPMM gjithashtu është e ngarkuar me detyrë edhe për luftimin e dukurisë së operimeve ilegale.

Në këtë drejtim realisht janë shënua progres dhe këtë vit ka numër më të vogël të operimeve ilegale sepse është rritë koordinimi me institucione tjera. Gjithashtu vitin e kaluar e kemi pasur një .. që i kemi involvua të gjitha institucionet që lidhen me sektorin minerarë dhe jemi marrë vesh për hartimin e një plani të veprimit për këtë dukuri për ndalim dhe parandalim të kësaj dukurie. Mirëpo kjo realisht është duke u zbatua tash për tash ky plan vetëm nga KPMM-ja dhe disa institucione nga Policia e Kosovës kohë pas kohe nga Ministria e Mjedisit kurse institucionet tjera faktikisht nuk janë tu e marrë për bazë këtë plan veprimi.

Kjo është mirë me qenë se hyhet një plotësim dhe ndryshim të futet ky plan i veprimit të futet si nene të posaçme në ligj edhe të obligohen edhe ato institucione, të obligohen për ndaljen e këtyre dukurive jo të mira të cilat fatkeqësisht po i shkaktojnë problem kompanive të cilat janë të licencuara, të cilat janë të ndërgjegjshme, paguajnë buxhetin e Kosovës, kurse fatkeqësisht e dëmtojnë, krijojnë jo lojalitet në shfrytëzimin e mineraleve.

Çështje tjetër është që në kuadër të operimeve ilegale të futet çështja e obligime të inspektorëve dhe të ministrive dhe komunave për parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale sepse në këtë fushë fatkeqësisht tash përveç me Ministrinë e Mjedisit kohë pas kohe që koordinohemi me komunat është pak situata më problematike.

Janë edhe disa çështje të cilat besoj që duhet të ngriten këtu me qenë se po fillon ndoshta edhe plotësim ndryshimi i ligjit është çështja e zonave të interesit. Çështja e lëndëve energjetike, madje çështja e shfrytëzimit të mineraleve në sipërfaqet e parqeve nacionale.

Mendoj se zonat e interesit me Ligjin për miniera e minerare janë shpallur nga Qeveria dhe që nga viti 2010 sot 6 vjet po bëhen nga viti 2009 faktikisht disa mandej 2010 janë gjithsejtë 11 zona të interesit të cilat faktikisht janë bllokua mineralet në ato zona, nuk po lejohet as hulumtimi as shfrytëzimi i tyre dhe kjo është në kompetencat të Qeverisë që faktikisht i shkojnë përmes procedurave të konkurrimit apo procedurave të tjera përmes komitetit për investime publike private që është i ngritur pranë Qeverisë së Republikës së Kosovës këto kanë ngec edhe faktikisht në këtë drejtim mendoj se Kosova është shumë keq edhe duhet me marrë hapa të tjerë, duhet me e ndryshua këtë qasje ose duhet t'i epet përgjegjësia një institucioni të vetëm ose nuk duhet të lihet përgjegjësia e shpërndarë pastaj këto kanë mbet pa u zhvillua sepse ka kërkesa nga investitorë të ndryshëm, nga kompanitë e ndryshme të cilat kanë shprehë interes për me u fut në Kosovë për me i .. në këto zona.

Ne kemi tekë çështja e lëndëve energjetike, po ashtu këtu Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale edhe në këtë çështje nuk lëshon licenca pa u marrë vendimi nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës, kështu është e rregulluar tash për tash me ligj.

Prandaj, edhe te kjo çështje mendoj se tash monopoli në Kosovë është vetëm një kompani pra vetëm KEK-u, kurse nuk ka asnjë operues tjetër në Kosovë që ka licencë ose leje për me operua.

Tash kemi dëgjua kohëve të fundit se janë paraqitur disa kërkesa dhe faktikisht Qeveria i ka miratua dy kërkesat të cilat kanë ardhur në Parlament, jemi njoftuar për atë. Po presim vendimet e Parlamentit, pastaj me procesu Komisionit të Pavarur për Miniera e Minerale, por në këto raste duhet natyrisht të ketë kujdes me ligjin për sipërfaqet dhe për kushtet, kriteret që janë të përcaktuara me ligj.

Gjithashtu, mendoj se Kosova nuk është aq e pasur që ta fut 30% të sipërfaqes së saj në Forcën Nacionale edhe pastaj të mos lejohet asnjë aktivitet minerar në zonat e forcave nacionale. Kjo mendoj se duhet edhe kjo çështje duhet të adresohet dhe rregullohet me ligj. Ka edhe çështje tjera, të cilat i kanë ngrit edhe bizneset. Janë burokracirat e mëdha që paraqiten sidomos në procedurat e aplikimit për leje të hulumtimit edhe leje të shfrytëzimit, sepse kompanitë detyrohen që të shkojnë nga një institucion në një institucion tjetër për të mbledh gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të aplikuar për një licencë.

Kjo është parë si një e metë, faktikisht në ligj këtë e kanë adresuar edhe USAID-i amerikan. I ka dhënë tri zgjidhje për këtë çështje, mirëpo realisht për ta inkorporuar në ligj ato pastaj duhet natyrisht që kjo di t'i kushtojë edhe buxhetit, sepse nevojiten edhe mjete buxhetore. Duhet të ngrit kapacitetet e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për me mujt pastaj për me zbatua përmes një zyre të vetme, domethënë me u pranua gjithë dokumentacioni dhe me u vendos komplet nga KPMM-ja, por duhet me u ngrit pastaj edhe Departament për Mjedis, Departament për Pyje në kuadër të KPMM-së.

Mendoj se këto ishin disa çështje pasi t'i dëgjojmë edhe të pranishmit që janë këtu, pastaj ndoshta do të kyçemi prapë në diskutim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Shabani!

Vërtetë ne kemi diskutuar këto çështje dhe kur kemi vizituar Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale i kemi diskutuar edhe gjatë kohës kur është shqyrtuar Raporti vjetor i punës suaj.

Kërkoj që edhe nga ju, por edhe nga të tjerët që specifikisht kur t'i dorëzojnë me shkrim në formë elektronike përmes administratës që mbështet komisionin parlamentar të thirrni specifikisht në dispozita dhe në nene të caktuara të ligjit, kështu që të kemi ne më lehtë të nxjerrim rekomandime për seancën, për Kuvendin. Pastaj, të shohim mundësitë dhe ta vlerësojmë se a vërtetë është e nevojshme që pas fazës së monitorimit të këtij ligji të hyjmë në plotësim ndryshimit bashkarish. Faleminderit!

Natyrisht, për propozime konkrete se si mendoni se si duhet të duken ato dispozita ligjore në mënyrë që operimet minerare të jenë sa më të lehta për bizneset dhe për të tjerët. Tani kush e do fjalën? Naser Peci, Fakulteti i Gjeoshkencave.

NASER PECI: Faleminderit, kryesuese!

Pra, jam Naser Peci nga Fakulteti i Gjeoshkencave në Mitrovicë, Universiteti i Mitrovicës.

E nderuara kryesuese,

I nderuari deputet Çela,

Faleminderit për ftesën,

Të nderuar pjesëmarrës,

Ligji që mbulon këtë sektorin e minerareve është shumë i rëndësishëm edhe shumë i lidhur me Fakultetin e Gjeoshkencave.

Kjo për arsye se nëse një ligj i përshtatshëm dhe një ligj i mirë i implementueshëm sjell investime në sektorin hulumtues dhe minerar në Kosovë, atëherë sigurisht që është një mundësi shumë e madhe dhe e punësimit, dhe e praktikës së studentëve nga Fakulteti i Gjeoshkencave se në Fakultetin e Gjeoshkencave pra se themi studiojnë inxhinierët e ardhshëm të gjeologjisë, të minierave dhe metalurgjisë.

Përveç kësaj, ... se si person i lëmisë ne kemi bashkëpunim me kompani të ndryshme qoftë vendore, qoftë ndërkombëtare që janë të interesuar për hulumtime dhe shfrytëzim të resurseve në Kosovë, sidomos disa kompani që kanë një mendim që themi ne më serioz, sepse ata fillimisht i qasen sa i përket ekspertëve të kësaj lëmie, institucioneve arsimore qoftë nga vendet ku vijnë, qoftë nga fakulteti jonë në Mitrovicë. Kështu që krijohet një bashkëpunim shumë i mirë edhe mes fakulteteve në rajon edhe në Evropë.

Kurse, sa i përket asaj konkret kisha me thënë edhe pak si njerëzit po na mundësojnë meqenëse jemi sektorë minerar, ... e përmendi edhe kryesuesi i Komisionit të Minierave. Ajo që intereson apo mos të them që kanë me has në ndonjë problem mirëpo mund të funksionalizojë ndoshta më mirë është harmonizimi i ligjeve në mes të institucioneve, rregullave relevante që kanë të bëjnë për marrjen e licencës, qoftë agjensioni, qoftë Ministria e Ambientit e kështu me radhë. Edhe po ashtu, e përmendi edhe prapë kryesuesja tha që është kompetencë e Qeverisë, më duket zonat e interesit.

Ka investitorë, ka investime që janë të interesuar që të themi të marrin licencë apo të fillojnë të hulumtojnë apo nëse pse jo edhe të shfrytëzojnë resurs të tillë të vërtetuar në zonat e interesit që tash janë të shpallura që nga ku thatë prej vitit 2008. Kjo, pra ishte ajo në përgjithësi nga pikat edhe nga aspekti i rëndësisë të implementimit, jo vetëm të implementimit por ligji të jetë sa më i përshtatshëm për investime që është shumë i lidhur me Fakultetin e Gjeoshkencave, por edhe nga aspekti që i tërheq investitorët sa më shumë në hulumtime dhe shfrytëzim të minerareve në Kosovë. Faleminderit edhe njëherë për ftesën dhe vëmendjen. Nëse ka diçka sigurisht që inkadrohem gjatë bisedës.

KRYESUESJA: Faleminderit! Dikush tjetër, urdhëro Ahmet Bytyqi.

AHMET BYTYQI: Unë jam Ahmet Bytyqi, përndryshe jam punëtor i KEK-ut. Sot nuk kam ardhur në cilësinë e përfaqësuesit të KEK-ut janë tjetërkush.

Unë kam ardhur në cilësinë e një eksperti të pavarur që merrem me fushën e shfrytëzimit sipërfaqësor. Salë, sigurisht e dinë që unë kam qenë ndër ata të parët

që jam mishëruar me ligj në debatet e para qysh kanë qenë edhe tash edhe me kohë i kemi artikuluar edhe disa mangësi që na u kanë përvjedh në ligj dhe që ato tash sigurisht nuk kanë pa ... ligjit, që nuk i kanë pa të arsyeshme aq për kohën të cilën tash do të hyjmë me siguri se do të jenë të nevojshme, meqë vi prej sferës edhe të prodhimit. Sigurisht që i kam identifikuar disa nëse në ligj nuk janë atëherë duhet të mbulohen me rregullore të cilat do t'i duhen ligjit, sepse ligji nëse si i tillë tërë veprimtarinë tonë do të thotë nuk e mbulon ligji se ka shumë zbrazëtira në aspektin e shfrytëzimit.

U tha këtu që sigurisht edhe prej zoti Musës që tash priten edhe investime të kompanive tjera që ligji nuk parasheh nëse një dokumentacion jashtë hartohet ligji jonë s'e parasheh si të tillë ne një makinë nëse e blejmë ajo duhet të homologohet. Te ne vjen vetëm i tillë dhe përdoren standarde të ndryshme duhet të përshtaten neve. Në theks të veçantë nuk e kam që të mos ju lodhi në lidhje me pikën e parë, tash unë nuk do t'i numëroj cilat ligje janë se i dimë më cilat janë në përdorim, po cilat nën akte nënligjore që i mungojnë ligjit tonë.

Nëse më lejohet unë i kam identifikuar një 15 që do të duhej t'i shoqërohen ligjit edhe ta bëjnë funksional ligjin që tamam të jetë si në aspektin e sigurisë, por edhe në aspektin e mirëvajtjes të procesit të punës, si të minierave sipërfaqësore, por edhe atyre nëntokësore, po edhe në bizneset private. Nëse më lejohet unë do të them që gjëja e parë që haset që mungon në ligj që është, që nuk e përkrahin mënyrën e shfrytëzimit sipërfaqësor, do të thotë i takoj asaj fushe nuk jepen forma se si duhet të shfrytëzohen rregullat se si duhet e që këtu e atakon edhe që ishte herën e kaluar kur ishit me një grup parlamentar në Mirash.

Theks të veçantë që e kemi pas formën e sigurisë së minierave sipërfaqësore. Në dokumentacion tonë ligjor ose në ligjin tonë absolut kund nuk precizohet se me çfarë forme duhet ta ruajmë stabilitetin në përpos asaj distancës së sigurisë që e kemi jashtë, por brenda nuk zgjidhet me ligj tonin kurrkund ligji nuk shkruan se me çfarë faktori të sigurisë. Do të thotë kjo do të duhet të mbulohet nëse nuk është e mundur të futet, disa ligje e kanë, por nëse nuk është e mundur me ligjin tonë atëherë duhet të zgjidhet në formë të rregulloreve.

Pra, Rregullorja për përdorimin e lëndëve plasëse ... aktivitetet minerare. Mungon, rregullore do të thotë nëse doni mund në pika të shkurtra ta sqaroj çka është thelbi i kësaj. Do të thotë, me Rregulloren e parë ose në qoftë se futet në ndryshim që duhet të merr parasysh edhe kur ligji ndryshohet shfrytëzimi sipërfaqësor duhet të jepen modalitetet se si duhet shfrytëzohet një vendburim, si ... cilat janë format, rruga, do të thotë në këtë kontekst.

Ose, vetëm si rregullore do të thotë kjo është disa shtete që e kanë e kanë deri në 50 faqe shkon se si duhet të zgjidhet kjo formë të mbulohet me Rregullore.

Rregullorja për përdorimin e lëndëve plasëse. Unë e di që është një ligj, por ai ligj absolut për ne nuk përket ajo për përdorim civil, nëse thotë dikush është ligji ai absolut nuk e zgjedh problemin e përdorimit të lëndëve plasëse në aktivitetet minerare që sot sigurisht Komisioni i Pavarur e ka kadastrën se sa operojnë sot gurore edhe sa përdorin, por rregullat dhe formën se si duhet të përdorim dhe metodat të cilat i përdorin në legjislaturën tonë nuk zgjidhen. Do të thotë unë konkretisht jam si projektues dua të shfrytëzoj norma, forma të tjetër kujt sepse ligjet tona nuk i kanë, nuk i potencojnë këto.

As secili inxhinier që merret me këto do të duhej të ketë këtë Rregullore ose të përshkruaj në ligj. Pastaj është rregullore tjetër që i mungon mbi përmbajtjen dhe përgatitjen e dokumentacionit teknik. Tash është shumë interesant që hasim jo aneks projekt, jo azhurnim jo. Forma të tilla të emërimit të projekteve, dokumentacioni teknik në xehetari unë nuk e di që ekzistojnë përpos që ne i përdorim.

Ka formë është projekti kryesor, projekti i thjeshtësuar ose projekti teknik. Do të duhej të zgjidhet edhe kjo formë. Në projekt nuk precizohet, profesor Dukagjin, më fal në ligj, do të thotë nëse kalohet... mirë. Kërkoj falje unë s'e kam parë, por do të kisha pas dëshirë ta kem. Rregullat ose Rregullorja për përdorimin e makinave minerare, do të thotë pajisjeve minerare në aktivitetet minerare.

Rregullore mbi përdorimin e makinave minerare dhe pajisjeve minerare në aktivitetet minerare. Këto janë dy lloje nëse dikush është i hamendur se çka do të thotë tjetër është makinë, tjetër është pajisje. Kjo nuk është e mbuluar, do të duhej te ne ja mos thuaj zot ku. Gjithë ato pajisje ne punohet vetëm në hamendje.

Pastaj, është Rregullorja mbi kontrollimin e objekteve minerare që është e pambuluar, Rregullore për ajrimin e minierave nëntokësore, Rregullore për përgatitjen e lëndëve minerale, Rregullorja për transportin me shirita, është shumë e nevojshme gjatë aktivitetëve minerare, sepse kemi ne edhe në fusha tjera që përdorim, por neve na duhet për nevoja që përdoren në aktivitete minerare. Që kemi bukur shumë 80-90 km shirita. Do të thotë është i pa mbuluar.

Është tjetër një çështje është rregullore që mungon për hulumtimin gjatë zhvillimit të aktivitetëve minerare, pastaj mungon një Rregullore mbi transportin e njerëzve,

materialet në pusët do të thotë transportin vertikal që e quajmë “në puse” edhe ato të pjerrët nëpër miniera. Pastaj mungon një Rregullore për shfrytëzimin e shkëmbinjve arkitektonik që tash ka filluar të na shfaqet si formë e shfrytëzimit që dallon prej gëlqeroreve, do të thotë formë e shfrytëzimit të mermerëve dhe gurëve dekorativ. Është një teknologji tjetër që përdoret aty, por jo me minim, por janë do forma tjera që do të duhej të zgjidhet kjo formë se si, pastaj e kemi që ndoshta është kryesorja kjo Rregullore për aftësimin profesional për kryerjen e disa punëve të veçanta në aktivitete minerare.

Pastaj, është për licencimin e personave për hartimin e dokumentacionit teknik që është fjala për projektues, do të thotë nuk e kemi të zgjidhur këtë problem. Pastaj, mungon një Rregullore që thashë këtu është shumë aktuale, siç e tha edhe Musa tash po pritet që të investojë dikush e ne nuk e kemi problemin e çështjes së atij që po flitet ndoshta se po bëhet ...

Duhet të kemi kujdes këtu shumë, se nëse një fushë që është një trashësi e shtresës së qymyrit prej 100 metra edhe në të bëhet shfrytëzimi do të thotë 80% prej 100 metra 80 metra mbetet zbrazëtirë unë nuk e di se si do të mendohet do të thotë. Legjislatura jonë duhet të ketë kujdes shumë që si do ta mbulojë do të thotë 80 metra me u lëshua një regjion, duhet mendojë dikush seriozisht në këtë drejtim, në këtë aspekt shfrytëzimit do të thotë të klasifikimit të qymyreve.

Unë nuk kam ... ta ftohi dikë, por ne ju në veçanti si parlamentar duhet të kemi në theks të veçantë që këtë të kërkojmë ndihmë prej dikujt me përvojë të tilla. Unë e di që ... bëhet nën gëlqeror, por në ... është pak e koklavitur. Edhe është një rregullore tjetër që do të duhej, që s’e kemi të zgjedhur edhe këtë problemi për matjet gjeodezike në aktivitetet minerare që mungon, që do të duhej të jenë disa rregulla në të që duhet të precizohen.

Do të thotë, këto janë ato shtylla, të cilat ligjin do ta bëjnë funksional, po të merrni do të thotë në të gjitha ligjet e shteteve përreth do të thotë i kanë të shoqëruara nëse s’e ka mbuluar me ligj i ka të shoqëruara me këto rregullore, të cilat e bëjnë funksional ligjin. Se ligji si ligj nuk i mbulon të gjitha, por atëherë duhet rregullore. Unë kërkoj falje ndoshta profesor Dukagjini, qenka po unë s’e kam parë mirë, që një prej 15 qenka, por janë edhe 14 tjera që do të duhej të mbulohen përndryshe nuk mund të themi se e kemi të mbuluar në aspektin funksional, në aspektin politik unë pajtohem që është ligji në rregull. Por, në aspektin funksional si profesionistë nuk konsideroj se na mbulon të gjitha problemet. Unë vi thash prej KEK-ut, ju e dini sigurisht se çfarë problemi kemi sot ne me KEK-un që sot tri sisteme janë ndal edhe ne kurrëgjë kurrëgjë.

Do të thotë, nëse këtu jetësohen këto do të thotë neve si profesionistë por edhe si komunitet projektues, por edhe të shfrytëzimit do të ndihmojnë shumë në mirëvajtje, por edhe në rritjen e sigurisë dhe stabilitetit të sigurisë së punëtorëve, por edhe vetë pajisjeve të cilat ... do të thotë këto janë ato shtyllat që janë të domosdoshme që t'i shoqërohen ligjit. Nëse nuk zgjidhen në ligj, nëse i hynë ndryshimit ka disa që mund të futen në ligj do të thotë shumë shtete i kanë të futura në ligj.

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Bytyqi!

Unë për hir të opinionit publik, por edhe të gjithë pjesëmarrësve këtu ua përkujtoj se Kuvendi e ka nxjerr një ligj për sigurinë e veprimtarive minerare i cili ligj besoj që i ka mbuluar disa prej sferave që i përmende ti, edhe natyrisht që zoti Bytyqi foli për akte nënligjore dhe rregullore, domethënë për legjislacion dytësor, të cilin besoj që ne gjatë hartimit të ligjit për sigurinë në veprimtarinë minerare e kemi pas parasysh që nuk mund të nxirret rregullore ose akt nënligjore i përgjithësuar për të gjitha operimet minerare, sepse i kanë specifikat e veta.

Veprimtaria minerare nëntokësore dhe sipërfaqësore nuk mund t'i kenë, të hartohen rregullativat e njëjta. Natyrisht që edhe te veprimtaria sipërfaqësore ka dallime shumë të mëdha mes atyre operimeve, bie fjala veprimtaria sipërfaqësore e lignitit me operimet minerare siç janë gurorët ose operimet më të vogla minerare.

Ne me ligj u kemi lënë hapësirë kompanive që t'i nxjerrin në bazë të specifikave dhe veprimtarisë së punës që i kryejnë, por edhe teknologjisë që i përdorin gjatë atyre operimeve të nxjerrin rregullat e tyre natyrisht konform standardeve të BE-së dhe konform specifikave të tyre që i kanë nëpër kompanitë e tyre.

Mendoj që këtë pikë do të ketë edhe dikush tjetër të shtojë, por sidoqoftë ne si deputetë jemi shumë të interesuar të dimë specifikisht ligji, dispozitat ligjore ku janë pengesat, të cilat ne duhet t'i ndryshojmë dhe t'i plotësojmë. Faleminderit, shumë për kontributin e secilit dhe për kontributin tuaj zoti Bytyqi.

Kush e do fjalën dikush tjetër?

KRYESUESJA: Pranvera Dobruna.

PRANVERA DOBRUNA: Faleminderit shumë!

Së pari, faleminderit për ftesë dhe për gatishmërinë për të bashkëpunuar për këtë çështje shumë të rëndësishme.

Do të doja së pari të ndalem në çështjen e fundit që e përmendët dhe që shumë ka vend, përcaktimi veç e veç i aktiviteteve minerare dhe dallimi në mes të minierave sipërfaqësore për thëngjill dhe të aktiviteteve gurore.

T'ua përkujtoj që KEK-u së fundmi ka pasur problem në licencimin e sipërfaqeve të blera të KEK-ut për eksploatim, për shkak se ligji që është amendamentuar nuk e ka përcaktuar mirë aktivitetet minerare të thëngjillit dhe gurëthyesve dhe ne si kompani publike është dashur të dalim me tender të hapur për t'u licencuar.

Prandaj, këtë çështje e kemi zgjidhur përmes intervenimit të kryeministrit, që ka të drejtë të kërkojë tejkalim të ligjeve dhe KEK-u e ka zgjidhur këtë çështje. Njëra prej çështjeve që Parlamenti duhet ta dijë, kjo është pengesa që KEK-u e ka hasur gjatë implementimit të ligjit, domethënë amendamenti i Ligjit të vitit 2013 në raport me 2010-shin. Këtë e kemi tejkaluar, sepse ka qenë nevojë imediate dhe kemi gjetur bashkëpunim të komisioni edhe të Qeveria për ta bërë këtë punë.

Çështje të tjera që KEK-u i has e që ju i dini, jeni të njoftuar, është çështja e eksproprijimit dhe çështja e mospërfundimit apo mos ndenjës kujdestarisë në zonat që janë të shpallura me interes publik, domethënë duhet dikush të rrijë kujdestar, është shpallur kjo zonë dhe duhet dikush të rrijë kujdestar për të mos u lejuar ndërtime. Kjo është diçka që Parlamenti duhet ta adresojë.

Dhe një çështje tjetër, që kisha dashur ta përmend dhe është çështje që unë jam marrë shumë riformimin e sektorëve apo tranzicioneve dhe me formimin e rregullatorëve ekonomikë, si atij në energji gjithashtu edhe në komisionin për miniera, kam qenë në ekipet që i kanë formuar. Kisha dashur dy udhëzime t'i jap. Raporti në mes të Parlamentit, Qeverisë dhe institucioneve të pavarura vendoset përmes ligjeve dhe instrumenteve që i përcakton ligji. Çka do të thotë kjo?

Nuk mund të themi në gjithë kohën "i kemi ca institucione të pavarura" e që nuk varen nga askush, i kemi disa institucione të formuara nga Qeveria apo Parlamenti, të cilët duhet t'i respektojnë ligjet apo instrumentet që ua lejon ligji apo politikat e ekzekutivit. Çka do të thotë kjo? Ligji ua lejon institucioneve të pavarura dy instrumente. Ato dy instrumente janë licencimi dhe tarifa dhe përmes licencimit, kushteve të licencimit dhe metodologjisë së tarifave që i aprovon Qeveria atëherë institucionet e pavarura janë autonome në vendimmarrje. Këto desha t'i them si definicione, meqenëse kam qenë negociuese e transicionit.

Pra, nuk duhet të harrojmë, është njëfarë trekëndëshi, ligji ua lejon institucioneve të pavarura dy instrumente: tarifat dhe licencimin. Ua përcakton kushtet e mandej në kuadër të atyre kushteve, atëherë veprojnë institucionet e pavarura, si Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, si Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Po dua ta bëj njëfarë ndarje në mes të pavarësisë dhe autonomicitetit në vendimmarrje. Nuk mund të themi që janë të pavarur nga politikat. Jo nuk mund të jesh, se ti je në këtë shtet. Çka i përcakton? Këto duhet të shfrytëzohen, deri në këto kushte, këto duhet të jenë tarifat, këto duhet të jenë përfitimet e Qeverisë, këto duhet të aprovohen përmes ligjeve në Parlament.

Ne të gjithë duhet të punojmë së bashku për një të mirë, domethënë me valorizimin e këtyre resurseve që i kemi, cilat janë mënyrat më të mira që t'i valorizojmë. Domethënë, këto janë kushtet parimore që duhet të vendosen përmes politikave që i përcakton Ministria e Zhvillimit Ekonomik e që i implementojmë ne të gjithë.

Edhe një herë po shkoj mbrapa, unë prezantoj Kompaninë Publike të KEK-ut, jam anëtare e Bordit dhe udhëheq Komitetin për strategji dhe biznes-plan dhe çështje rregullative. Mundohem gjithnjë të tregoj ku është kufiri në mes të rregullatorit ekonomik, i cili rregullon edhe kompaninë edhe bizneset dhe konsumatorët. Kjo është, rregullatori ekonomik e ka atë rol, t'i rregullojë të gjithë, asnjërin mos me e dëmtua, mirëpo se si bëhen këto dikush ua përcakton, ia përcakton Qeveria me politika dhe Parlamenti me ligjet dhe instrumentet që ia jep.

Domethënë, këto desha unë t'i sqaroj për shkak të eksperiencës që e kam. Nëse dikush ka tjetër pyetje apo disa konstatime që përgjegjësit në KEK i kanë definuar, unë mendoj se ka në KEK mjaft ekspertizë ... shumë teknokratë dhe çështjet teknike dinë t'i definojnë në mënyrën më të mirë të mundshme dhe është mirë me i konsultua gjatë amendamentimit të ligjeve, për të mos ardhur në pozitë që mandej me shkua të kryeministri për të kërkuar tejkallim të ligjeve, për shkak se nuk është paraparë. Unë me përgjegjësi të madhe them, që edhe te çështjet e energjisë elektrike dhe të minierave në KEK ka shumë ekspertizë. Faleminderit që e keni gjetur mënyrën për t'ua dhënë një platformë që ata të bisedojnë dhe të tregojnë, se ku i kanë hasur ata problemet gjatë implementimit të ligjeve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Dobruna. Po e përsëris edhe njëherë, jeni të mirëseardhur çdoherë. Kuvendi i ka publike në ueb-faqen e vet të gjitha angazhimet dhe aktivitetet e veta, prandaj edhe nëse ndonjëherë nuk merrni drejtpërsëdrejti me email zyrtar ndonjë ftesë, jeni të mirëseardhur. Faleminderit. Kush e do fjalën?

GËZIM TËRNAVA: Quhem Gëzim Tërnavë, vij prej Divizionit të Qymyrit – KEK. Po vazhdojmë pasi që veç ishim te KEK-u.

Duke mos dashur ta zgjas shumë dhe përafërsisht ato komentet tona që i kemi dhënë u prekën edhe prej parafolësve. Si tema më problematike momentalisht kemi procedurat e shpronësimit, që u cekën edhe prej përfaqësueses së Bordit, kemi problemin, ku prej përfaqësuesit të KPMN-së u cek edhe sipërfaqet dhe garancitë për sipërfaqet për kultivim, që te KEK-u është një problem shumë i madh duke pasur parasysh, se vetëm projekti Sibovc-jugperëndim ka 500 mijë hektarë, ku kërkohet një sigurim prej 12 mijë euro për një hektar, është një vlerë shumë e madhe, pa i marrë në konsideratë, në këtë rast edhe pjesën e mbetur, pjesën paraprake që kalon mbi 2 mijë hektarë. Do të thotë, te sigurimet, sipërfaqet, afatet e shfrytëzimit, po besoj se kemi me pas rast këto me i definua, nëse veç hyjmë në rishikim të ligjit.

Kemi telashin e ngritur rreth tantimës për shfrytëzimin e qymyrit, kufirin e sigurisë, që në njëfarë forme na obligon me një lloj shablloni, pa llogari gjeomekanike, se pavarësisht në cilin formacion punohet në një minierë, është përcaktuar një distancë e cila neve na ngarkon shumë tek eksproprijimi. E kemi problemin, pastaj edhe siç u cek më herët, zonën e interesit. hapësira ku operohet sot në divizionin e Qymyrit e dimë se është shpallur “zonë e interesit 2004, 2009 e kështu...” kemi telashe të krijuara brenda këtij afati edhe pasi veç është shpallur zonë interesi, që sot jemi në situatë tepër të vështirë tek shpronësimet dhe zhvendosja aktualisht tri lagje të fshatit Shipitullë. Kronologjia e ndërtimeve aty është e raportuar çdo muaj prej Divizionit të Qymyrit, por nuk ka pasur një, siç tha parafolësja, një kujdestar që ato ndërtime të mos ndodhin.

Do të thotë, janë këto disa probleme në vija të trasha të cekura, duke pasur besim se në të ardhmen do të kemi mundësi t’i harmonizojmë qëndrimet edhe kërkesat tona do të përfshihen në ligj, tek rishikimi. Nuk kisha dashur ta zgjas më shumë. Domethënë, tantiema është problem, kufiri i sigurisë është problem, garancitë bankare për sipërfaqet dhe rikultivimin janë problem shumë i madh, procedurat e licencimit janë problem, ndërsa problemi më i madh aktual është shpronësimi.

Tek shpronësimi ne kemi telashe shumë, shumë të mëdha. Siç e tha edhe Ahmeti më herët, ne sot i kemi sistemet e ndalura, jashtë operimit, për shkak se nuk jemi ne ata që marrin vendim për shpronësim, ose zhvendosje të një lagjeje apo një shtëpie të vetme. Do të thotë, këto procedura duhet të rregullohen ashtu që kompanive, siç është KEK-u, të mos u paraqesin problem, ose më thjesht Kompanive siç është KEK-u, ose minierat e qymyrit, nesër ndoshta s’do të jenë

KEK, mund të jenë kompani e minierave, që është publike. Unë nuk besoj se mund të trajtohen me të njëjtin ligj me të cilin trajtohet një gurthyes. Është kompani publike, është kompani me rëndësi shtetërore, nuk di qysh do të mund të gjejmë një mirëkuptim në mënyrë që kjo kompani të veçohet prej kompanive ose operatorëve të tjerë minerarë. Operator minerar mund të jetë edhe një biznes familjar, një gurthyes. Nëse trajtojmë gurthyesin dhe minierat e qymyrit me të njëjtin ligj, besoj se vazhdimisht do të kemi problemet që i kemi sot.

KRYESUESJA: Faleminderit! Besoj se këtu që jeni prezent, ka dikush të japë edhe ndonjë përgjigje për njëri tjetrin, por unë jam e bindur që kompanitë publike, siç është KEK-u, por edhe “Trepça” që nuk e ka një status tamam të duhur, nuk trajtohen bash njësoj me ligj, i kanë do specifika lehtësuese dhe këtë më së miri e dinë përfaqësuesit e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale. Por sidoqoftë, nuk është situata më e mirë e mundshme, po prandaj edhe jemi mbledhur këtu sot dhe po diskutojmë e debatojmë se si t’i gjejmë format ligjore, në mënyrë që vërtet këtë pasuri që e ka Kosova ta valorizojmë. Faleminderit shumë!

Dikush tjetër? Selvete Grajqevci.

SELVETE GRAJQEVCI: Faleminderit! Unë jam Selvete Grajqevci-Pllana, kryesuese e Departamentit ligjor në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale.

Pas fjalëve që kryesuesi i Bordit i ceku këtu, të gjitha këto probleme që hasim çdo ditë në zbatimin, implementimin e këtij ligji, unë si kryesuese e Departamentit ligjor desha të cek edhe disa plotësime të tjera, që deri më tash nuk u cekën.

Gjatë kohës së zbatimit të Ligjit për miniera dhe minerale, ajo që ne hasim në pengesë si Departament ligjor në zbatimin e këtij ligji, është çështja e sekuestrimeve. Në nenin 70 të Ligjit për miniera dhe minerale, paragrafi 3, është paraparë mundësia që operatorët ilegalë gjatë kohës kur bëhet inspektimi dhe hasen duke bërë operim ilegal, atëherë u është dhënë mundësia inspektorëve që të bëjnë sekuestrimin e mjeteve me të cilat punohet dhe mineraleve të cilat hasen në vendin e ngjarjes. Deri më sot ky nen është zbatuar shumë pak. Ajo që ne kemi hasur si pengesë deri më tash është Agjencia për ruajtjen dhe konfiskimin e pasurive të sekuestruara.

Me Ligjin për miniera dhe minerale derisa na është dhënë mundësia për të bërë sekuestrimin e këtyre mjeteve, ata kërkojnë nga Gjykata që të marrë një vendim të veçantë dhe me vendim të veçantë të zbatohet sekuestrimi i mjeteve. Ne kemi

provuar edhe në këtë mënyrë. Kemi bërë biseda me kryeprokurorë e me gjykatës e prokurorë, se si të zbatohet ky nen, sepse deri më sot kemi hasur në pengesa shumë të mëdha, kemi qenë të penguar për zbatimin e sekuestrimit. Ata kërkojnë një vendim të veçantë nga Gjykata. E kemi provuar edhe këtë mënyrë, kemi shkuar në Prokurori, kemi dorëzuar dokumentacionin për ta bërë sekuestrimin. Aty ka ngelur puna. Tash është shkëputur kjo hallka e veprimit ndërmjet institucioneve. Ne si KPMM me anë të këtij vendimi duhet ta dorëzojmë dokumentacionin në Agjencinë për sekuestrim të mjeteve dhe ata ta bëjnë sekuestrimin, ruajtjen dhe menaxhimin më tutje të pasurisë, derisa Gjykata të marrë vendimin përfundimtar.

Në këtë drejtim kemi pasur pengesa shumë të mëdha deri më sot, në mënyrë që tash e tutje t'i zbatojmë këto norma dhe të ndërmerren të gjitha këto masa. Kërkoj një zgjidhje. Qysh të veprohet tash e tutje, të ceket edhe në ligj, definitivisht që pas sekuestrimit Agjencia duhet t'i marrë ato mjete dhe të menaxhojë me to e jo t'i mbeten barrë KPMM-së, pasi që ato mjete hasen në punën e përditshme të veprimeve ilegale. Kjo ka qenë njëra.

Një pikë tjetër, që desha ta cek këtu, është edhe te këto masat, sanksionet, që Ligji i minierave dhe mineraleve i ka paraparë. Deri më tash neni 79 dhe 80 i ka paraparë dënimet për veprimtaritë ilegale. Njëra prej pikave të nenit 79 thotë që “nëse operatori haset duke vepruar ilegalisht, i shqiptohet një gjobë deri në 6 muaj dhe dënimi me të holla.” Deri më tash ende nuk kemi pasur nga gjykata një shqiptim të gjobës me burg, siç është paraparë me Ligjin për miniera dhe minerale. Domethënë, këto masat që u shqiptohen operuesve ilegalë janë shumë të buta dhe nuk e kanë efektin e vet. Dënimet që shqiptojnë gjykatat sot, me nga 200-300 euro, nuk kanë efekt.

Te neni 13 desha pak te ndryshim-plotësimi, se gjatë punës së përditshme edhe me stafin e KPMM-së e kemi vërejtur, se neni 13 te përkufizimet i ka paraparë të njëjtat norma sikur pengesat ligjore te licencat për shfrytëzim ashtu edhe te aktivitetet e veçanta, ku hyjnë: reparacionet, bazat e asfaltit dhe bazat e betonit.

Në këtë drejtim kemi marrë disa propozime prej stafit, që te lejet e aktivitetit të veçantë distanca që është 500 metra objektet edhe prej rrugëve, të zvogëlohet, sepse kjo distancë për këto makineri është pak e madhe. Unë s'kam diçka më tepër, por nëse ka ndonjë pyetje...

KRYESUESJA: Faleminderit! Ishin vërejtje specifike në dispozita të caktuara. Besoj se do t'i marrim parasysh. ... zbatim të ligjit që ato nuk... domethënë janë institucione tjera që ne duhet t'ua tërheqim vëmendjen, po janë edhe specifika të

tjera, që nuk zbatohen këto ligje. Ne jemi të njoftuar se ka shumë lëndë që presin nëpër gjykata...
Dikush tjetër?

AHMET BYTYQI : Një plotësim e kam ndarë, por që harrova ta përmend, në këtë vazhdimësi.

Nëse më lejohet, vetëm një minutë.

Tash po kaloj te KEK-u, ku është hasur ky problem. Te neni 86 thotë, pikërisht lidhet me nenin 13, thotë: “Një licencë e lëshuar, para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të thotë vazhdon të mbetet në fuqi, nëse është lëshuar në përputhje me ligjin ose rregulloren që ka qenë në fuqi.” Por, për çudinë tonë, në nenin 86 të të njëjtit ligj thotë, ky ligj shfuqizon dhe zëvendëson Rregulloren e UNMIK-ut 2005/3. Këta të Komisionit të Pavarur e dinë që ne pikërisht këtë rregullore, që neni 88 e shfuqizon, ne tash jemi duke e respektuar në raport me 200 metra që është në të. Kjo duhet të fshihet njëra, se është e pakuptimtë. Tash, ti thua në nenin 86 “duhet ta zbatojë”, kurse në nenin 88 thua “e shfuqizon”.

KRYEUESJA: Besoj se këtë përgjigje e kanë Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe logjika po ma thotë, se vlen ligji i mëparshëm për aq kohë sa e ka licencën ndoshta, derisa i zgjat licenca për atë veprimtari që është licencuar më herët, përndryshe me skadimin e licencës do t’i nënshtrohet ligjit në fuqi.

Dikush tjetër?

AHMET BYTYQI : Mirë, meqë nuk duhet thash... shiqo, tingëllon keq, domethënë në nenin 86 ti kërkon prej dikujt që ta zbatojë një rregullore, që në nenin 88 i thua se e shfuqizon.

KRYEUESJA: Dikush tjetër...?

MUSA SHABANI : ... Nuk e ka fuqinë asnjë ligj, këtë duhet ta dish, asnjë ligj nuk mundet në mënyrë retroaktive t’i ndërrojë, ose mbrapa, për shembull, ka pasur në Kosovë qindra licenca. Ti s’mundesh tash, u bë ligji i ri apo licencat me i anulua e me bë licenca të reja me kushte të reja. Ato do të vlejnë derisa të përfundojë afati i tyre. Kur përfundon afati i tyre, pastaj u nënshtrohen kushteve të reja për licencim. Kjo është me ligj e rregulluar shumë mirë.

KRYEUESJA: Kush e do fjalën? Urdhëro!

KEMAJL ZEQRIRI: Kemajl Zeqiri prej Komisionit për Miniera dhe Minerale.

Unë nuk kam çfarë t'i shtoj fjalimit që e mbajti kryesuesi i Bordit lidhur me Ligjin për Miniera dhe Minerale dhe vështirësitë që kemi hasur gjatë zbatimit të tij.

Megjithatë, desha të theksoj se bashkërisht kemi marrë pjesë në disa konferenca, ka qenë pikërisht edhe zonja deputete në Toronto dhe në disa forume të ndryshme është cekur që Ligji për Miniera dhe Minerale i Kosovës është bukur i avancuar në krahasim me ligjet për miniera dhe minerale të regjionit. Është fjala për dispozita ligjore dhe jo për legjislacion sekondar.

Do të thotë, edhe unë pajtohem se ka nevojë ligji të plotësohet me legjislacion sekondar dhe mbase diku me provizione të caktuara të bëhen ndryshime, siç është garancioni bankar me tri AAA të cilin standard nuk e kanë bankat e Kosovës dhe në njëfarë forme, do të thotë, na qet në lajthitje neve që e zbatojmë ligjin dhe pastaj, ndoshta do të ishte mirë, të futet në një nen ku thuhet se përveç inspektorëve të KPM-së, obligohen edhe inspektorët komunalë dhe Policia e Kosovës që t'i ndalojë operuesit ilegalë sepse praktikët flasin që Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ishte dashur të merret me operimet legale, por me këtë rast ne merremi edhe me operime ilegale, sepse praktikët ndërkombëtarë flasin që me operime ilegale merren policia, prokuroria dhe gjyqësia dhe jo inspektorët e minierave.

E di që është ky debat për Ligjin për miniera dhe minerale, mirëpo desha të inkurajoj Komisionin që të bëjë edhe shikimin e Strategjisë minerare, e cila është e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe nëse e shikoni me kujdes, po të ishin zbatuar me përpikëri politikat e shprehura në atë strategji mbase shumica e këtyre debateve do t'i kishin zgjedhur këto çështje të cilat sot i ngritëm.

Sa i përket resurseve të linjtit, Strategjia minerare e ka paraparë zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme dhe ka paraparë se këto operime në shkallë të vogla ilegale, i ka paraparë në thonjëza po e them legalizimin e tyre përmes legjislacionit sekondar dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, e që në raport me bashkësinë ndërkombëtare ose standardet ndërkombëtare janë mjaft të pranueshme sepse BE sot po e inkurajon zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla e të mesme minerare, duke u munduar t'i iket njëfarë forme prej si quhen “llors ske majning” për shkak të efekteve negative që i ka në mjedis.

Prandaj, zbatimi i Strategjisë minerare do të na ndihmonte shumë edhe në përmirësimin e legjislacionit.

Dhe tjetra, çka desha të them, është se edhe unë pajtohem që ndoshta Ligji i minierave dhe mineraleve ishte dashur të fragmentizohet në kuptimin që të vlejné standarde të ndryshme për veprimtarinë minerare të mëdha, të themi “llors ski maining” siç është KEK-u, ta zëmë, e “Trepça” dhe të ketë specifika të ndryshme për.... sepse i kanë të ndara praktikatat ndërkombëtare, ka “smoll ski maining” dhe “lord ski maining” dhe tash në gjuhën shqipe do të thotë do t’ia përshtatim.

Dhe, krejt në fund, desha të them se sa i përket licencës së KEK-ut dhe trajtimit të KEK-ut, që e tha edhe zonja deputete, sa i përket Trepçës dhe KEK-ut Ligji për miniera dhe minerale parasheh lehtësime, dhe është neni 49 i parasheh ato dhe ju e dini që i kemi marrë licencat, përkundër se nuk i keni plotësuar kriteret, por pikërisht duke u thirrur në atë nen – 49, i mundësohet Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale t’u japë licencën.

Ndërsa, edhe një plotësim i vogël, do të thotë nuk është bërë asnjë anashkalim ligjor kur i është dhënë licenca KEK-ut dhe është kërkuar në bazë të nenit 49 një vendim i kryeministrit që përcaktohet me ligj dhe nuk është bërë asnjë anashkalim ligjor por është gjithçka në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit shumë për këto sqarime të vlefshme. Dikush tjetër? Udhëro! Gani Maliqi!

GANI MALIQI: Unë jam përfaqësues i Kompanisë Peshter Maining, që është konzorcion i firmës të Australisë dhe të Kanadës.

Sa i përket Ligjit për Miniera dhe Minerale, në përgjithësi mendimi i këtyre dy kompanive që natyrisht kanë përvojë të madhe në sektorin e minierave dhe mineraleve është ligj i avancuar, vetëm se do implementim praktik adekuat.

Natyrisht se Ligji duhet përcjell edhe me rregullore tjera përcjellëse, të cilat e rregullojnë çdo sektor ose çdo fushë minerare, që i përmendi edhe Ahmeti.

Unë pajtohem me parafolësit në lidhje me të metat ose mangësitë që i përmendi edhe shefi ose drejtori i KPMM-së, sidomos harmonizimi me ligjet tjera, me pylltari ose Agjencionin e Pylltarisë dhe dëshira jonë është që të kemi një vend, vetëm një vend për t’i rregulluar dokumentacionet, për shembull siç është KPMM

e jo të shkojmë edhe në komuna, në agjencione, në Ministri e KPMM, që do të thotë në shumë adresa për zgjidhjen e problemeve.

Unë edhe sot e dëgjova këtu, e edhe përpara kam dëgjuar se Kosova është e pasur me pasuri të ndryshme minerale dhe natyrisht, këtë e dimë, por të gjitha këto janë supozime për derisa ne nuk mund të dëshmojmë me anë të hulumtimeve se është e pasur. Dhe në qoftë se mbesim vetëm në fjali, atëherë ne nuk mund t'i përkthejmë në terma ekonomikë.

Në përgjithësi, vërejtja ime, megjithëse kompania jonë po kalon prej stadi të hulumtimeve në stadin e shfrytëzimit dhe shpresojmë se do ta vendosim një minierë në projektin e Slivovës, është se gjatë studimit të fizibilitetit që jemi duke e bërë tash, do të thotë, nevojitet një kohë shumë e madhe për marrjen e të dhënave dhe të projektit përfundimtar, dhe atëherë do të ishte mirë që kur të paramendohet do të thotë kjo fazë leja e hulumtimit gjeologjik mos të ndahet përgjysmë, për shembull, por të paramendohet me ligj. Domethënë, gjatë stadi të studimit të fizibilitetit leja e hulumtimit, edhe pse i kalon dy vjet, mos të ndahet në 50%, domethënë që duhet me u zvogëluar sipërfaqja te KPMM-ja.

Ndoshta është kjo jashtë... dhe i kisha bërë pyetje KEK-ut, për shembull, a janë në gjendje ta furnizojnë kompaninë tonë me rrymë dhe të lidhet me rrymë me KEK?

(Ndërhyje)

Po, për KEDS-in, e kam fjalën!

KRYESUESJA: Faleminderit shumë Gani Maliqi! Ne duhet gjithsesi t'i stimulojmë dhe inkurajojmë kompanitë serioze të cilat qe sa vite janë duke bërë hulumtime në Kosovë dhe natyrisht se ne do të bëjmë përpjekje që të kemi lehtësira, natyrisht, gjithmonë në suaza të ligjit dhe kërkoj që specifikisht ajo që ka të bëjë me ligjit t'i shkruani në formë elektronike dhe t'ia drejtoni koordinatorit të Komisionit. Faleminderit shumë!

Kush e do tjetër fjalën? Urdhëroni!

FIDAIM SAHITI: Faleminderit! Unë quhem Fidaim Sahiti, nga Shërbimi Gjeologjik i Kosovës.

Lidhur me këtë çështja desha të cek një çështje e cila është me rëndësi rreth ligjit, kohës së licencimit të kompanive për licenca.

Është bërë praktike se shumë kompani, që e di edhe Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve se marrin licenca për hulumtime në periudhën kohore për shembull prej dy viteve dhe asnjë aktivitet të hulumtimeve minerale nuk e ka dhe në një formë aty uzurpohet ajo zonë, qoftë për hulumtime të metaleve të ndryshme dhe plus dy vitet tjera ose tri vitet, si është e parashikuar me ligj, në një formë po shkon 5 vite pa asnjë aktivitet ose shumë pak aktivitet.

Në këto forma, në një formë mundësohet që të abuzohet me atë hapësirë të hulumtimeve minerare.

E kam fjalën për t'u precizuar jashtëzakonisht mirë në ligj që t'i jepet mundësia kompanive serioze, e jo njerëzve të cilët merren me kontrabandë ta quajë ashtu të hapësirës për hulumtime dhe mos t'i jepet hapësirë dikujt tjetër ose bizneseve tjera që vërtet kanë një potencial për hulumtime ose një seriozitet për hulumtime të mëtutjeshme, sepse ajo formë po mbahet peng. Pra, bëhet kjo për 3 a 4 vite, dhe 4 vite ne nuk kemi kohë të presim për shembull për një hulumtim të tillë, për çka një kompani është me mjete shumë të ulëta ose fare hiq, tenton ta uzurposh apo ta mbajë në peng atë pjesë.

Kjo kishte me qenë diçka që i jep shkas ose shtytje zhvillimit ekonomik në sektorin minerar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Dikush tjetër? Urdhëroni!

NASER PEÇI: Nëse më lejohet, shumë shkurt për një koment lidhur me këtë që tha Fidaimi.

Meqë janë edhe përfaqësuesit e KPMM-së, konsideroj me sa e njoh ligjin, këta e kanë mundësinë, nëse implementohet ligji që kompanive të tilla që raportojnë çdo vit, dhe të kërkohet nga to, që nëse konstatohet se një zonë është e zënë, ligji ia mundëson që të tërhiqet licenca për shkak të mosveprimtarisë.

(Ndërhyrje)

Po, është e mbuluar këto edhe kërkohen dhe në raste të tilla të implementohet dhe zbatohet ligji dhe rregullohen këto çështje. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Unë kisha dëshiruar të dëgjojmë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të cilët janë kyç në propozimin e ligjeve në këtë sferë. Nëse do dikush vullnetarisht, po kërkoj për fjalën e tyre!

DUKAGJIN SHALA: Jam Dukagjin Shala, udhëheqës i Departamentit të Minierave – në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Unë mund të cek se Departamenti nga fillimi i themelimit është angazhuar që të hartojë ligjet dhe aktet nënligjore për sektorin minerar. Deri tani është hartuar ligji, siç e cekën edhe parafolësit e mi, për miniera e minerare në vitin 2010 i cili është plotësuar dhe ndryshuar në vitin 2013, dhe pastaj në bashkëpunim me komisionin dhe grupin punues të komisionit parlamentar është hartuar edhe Ligji për sigurinë dhe veprimtarinë minerare, si dhe Ligji për shërbimin gjeologjik të Kosovës.

Në kuadër të akteve nënligjore gjer tani është hartuar:

Udhëzimi administrativ; Rregullat dhe procedurat e mbledhjes së rentës minerare; Rregullorja për përmbajtjen e Programit të hulumtimeve gjeologjike dhe Elaborati i rezultateve të hulumtimeve gjeologjike; Rregullorja për trajtimin e komunitetit në sektorin minerar, e cila është plotësuar dhe ndryshuar në vitin e kaluar; Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Muzeut shtetëror të kristaleve; Rregullorja për siguri minerare, e cila, siç e ceka edhe më herët, është shndërruar në ligj për sigurinë dhe veprimtarinë minerare; Rregullorja për administrimin e mbetjeve nga veprimtaria minerare; Rregullorja për përmbajtjen dhe mënyrën e hartimit të projekteve minerare; Rregullorja për sistemin informativ unik për resurset minerare, si dhe e fundit që është hartuar, Udhëzimi administrativ për klasifikimin dhe vlerësimin e resurseve të rezervave minerare dhe mbajtja e evidencës së tyre. Kjo është rregullore e re, e cila parasheh llogaritjen e rezervave dhe mbajtjen e evidencës me metoda bashkëkohore të cilat i përdorin edhe shtetet më të zhvilluara.

Afati i aplikimit është katërvjeçar, deri në vitin 2020, për shkak se kjo është metodë e re, kështu që raporti mund të paraqitet edhe në sistemin e vjetër dhe në sistemin e ri deri në vitin 2020, kur atëherë parashihet raportimi vetëm në sistemin e ri.

Sa i përket vërejtjeve që i dhatë, unë ju përkrah dhe mbështes, mirëpo konkretisht ne si Ministri vërejtje ose kërkesë për plotësim-ndryshim të ligjit nuk kemi marrë, përveç KEK-u që e ka dorëzuar kërkesën për shqyrtimin e mundësisë së zvogëlimit të largësisë prej shtëpisë së fundit, pra distancës së shtëpisë së fundit dhe vijës së

shfrytëzimit, që me Ligjin e vitit 2012 ka qenë 100 metra kurse me plotësim-ndryshimin është bërë 250 metra.

Kjo është bërë faktikisht më shumë në kërkesë të Komisionit të Pavarur, meqenëse kanë pasur shumë probleme me kompani të ndryshme të cilat gjatë minimumit apo shfrytëzimit fshatarët kanë qenë faktikisht të mbijetojnë në ato kushte dhe për këtë arsye është miratuar dhe plotësuar ligji, që 250 metra lejohet shfrytëzimi pa minim, kurse në 500 metra është distanca për minim.

Kjo ka qenë e arsyeshme dhe atëherë kur e kemi diskutuar kanë qenë të gjithë përfaqësuesit dhe janë pajtuar me këtë.

Pra, kërkesa e KEK-ut ka qenë që të shqyrtohet mundësia, mirëpo Ligji faktikisht është e pamundshme të ndërrohet brenda ditës, dhe ne kemi thënë se do ta shqyrtojmë kur bëhet plotësim-ndryshimi i ligjit, mirëpo kemi gjetur mënyrën tjetër ligjore dhe është marrë pëlqimi dhe e keni kryer këtë problem.

(Ndërhyrje)

Jo, distanca nuk është kryer. Normal se distanca nuk kryhet për ndërrimin e ligjit, ajo kuptohet.

KRYESUESJA: A do ndokush fjalën, apo ndonjë pyetje?

DUKAGJIN SHALA: Sa i përket harmonizimit të ligjit, ne kemi biseduar me Agjencionin Pyjor dhe ata na kanë premtuar se do t'i marrin për bazë të gjitha kërkesat. Pra, meqenëse Ligji për Miniera e Minerale është ligj bazik, atëherë edhe ata duhet t'i përshtaten afateve dhe sipërfaqeve të përcaktuara me këtë ligj. Na kanë premtuar se do ta bëjnë këtë plotësim-ndryshim dhe shpresoj se do të ndodhë edhe kjo. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit shumë! Ndokush tjetër? Nëse s'paraqitet më askush për fjalë, do t'ia kaloj mundësinë për ta marrë fjalën deputeti Raif Qela.

RAIF QELA: Të nderuar të pranishëm, përshëndetje për të gjithë!

I dëgjova të gjitha diskutimet me vëmendje dhe pashë se dhatë plot të dhëna lidhur me atë se në çfarë drejtimi do të mund të plotësohej dhe ndryshohej Ligji për minierat dhe minerale dhe kjo padyshim do të jetë një ndihmesë e madhe për institucionet përkatëse që të ndërmarrin veprime sa më shpejt që të plotësohet dhe ndryshohet ky ligj, aty ku ka nevojë.

Desha të ndalem vetëm te një çështje. Kryesuesi i Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, zoti Shabani përmendi se në Komision kanë ardhur dy shprehje të interesit, përkatësisht dy vendime të Qeverisë lidhur me shprehjen e interesit për dy projekte të ndryshme lidhur me rezervat e qymyrit në rajonin e Dukagjinit.

Komisioni, pas debatesh të shumta dhe analiza e ka dhënë pëlqim të dyjave për licencim, dhe jo edhe për shfrytëzim nga shkaku se që të dy këto projekte kanë të panjohura të shumta për deputetët.

Si rezultat i kësaj ka dalë edhe prej Komisionit për zhvillim ekonomik dy rekomandime lidhur me këto dy çështje të cilat mund të shohim sot se janë precizuar saktësisht që këto licenca përkatësisht miratimi është dhënë vetëm për licenca për hulumtim e jo edhe për shfrytëzim dhe është pikë e veçantë e këtij rekomandimi që i drejtohet seancës në të cilën thuhet se para marrëveshjeve eventuale për realizim të projektit të shfrytëzimit Qeveria obligohet ta sjellë vendimin për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Me fjalë të tjera, deri sa kemi këtu të panjohura lidhur me këto dy projekte, ne kemi dhënë miratimin vetëm për licenca për hulumtim, pra për shprehje të interesit për miratim për licenca vetëm për hulumtim dhe jo edhe për shfrytëzim. Këtë duhet ta keni si njohuri dhe sigurisht se ju nevojitet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! A e do fjalën dikush, ndoshta do të shtojë diçka?

MUSA SHABANI: Faleminderit!

Është edhe një çështje tjetër te Ligji, te mineralet energjetike. Aty faktikisht me ligj mbulohet vetëm pjesa e linjtit. Ligji nuk mbulon aspak për hidrokarburet e gazta ose të lëngëta. Pra, nuk është e përfshirja. Kjo çështje ose duhet të rregullohet me një ligj të posaçëm ose duhet të futet si pjesë në ligjin aktual. Pra, nëse futet ndryshim-plotësimi duhet të përfshihet edhe hidrokarburet e lëngëta dhe të gazta sepse nuk janë të parapara në ligj fare. Pra, as për hulumtim, as për shfrytëzim, dhe për asnjë tjetër.

(Ndërhyrje)

Jo, ato janë për shfrytëzim të hidrokarbureve të ngurta – të qymyreve, por për ato ka, janë dy nene kurse për këto të lëngëta, për naftën dhe për gazin nuk ka fare.

KEMAJL ZEQRIRI: Këtë po themi se kemi pasur kërkesa për hulumtim, janë ato shumë kompani të interesuara sa i përket hulumtimit të naftës. Ne nuk kemi legjislacion...Do të thotë, këtë që e tha kryesuesi ne po e bazojmë në bazë të praktikave dhe diskutimeve që i kemi pasur me kompani të ndryshme, ka qenë edhe zonja deputete bashkërisht në Toronto dhe ka pasur një numër të madh të kompanive të cilat kanë qenë të interesuara për hulumtimin e hidrokarbureve të lëngëta dhe të gazta – naftës dhe gazit. Mirëpo, aktualisht Ligji i minierave dhe mineraleve nuk e mbulon këtë fushë dhe ne kërkojmë që ose të futet në kuadër të ligjit pas plotësim-ndryshimit ose për këtë, nëse është e nevojshme,të hartohet edhe një ligj i veçantë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit shumë! Konsideroj se debati u shter! Sigurisht se secili nga ju keni çka të shtoni ende dhe ne presim dhe mirëpresim të gjitha vërejtjet e sugjerimet në nene specifike me propozimet e reja dhe të veçanta siç doli nga ky debat publik.

Ajo që kam mund ta evidentoj gjatë këtij debati dhe t'i gjej ato pika të përbashkëta të shqetësimeve nga ky debat janë garancionet bankare, zonat e interesit, zhbllokimi i tyre dhe nevoja për një ... stop-shop që bizneset mos të bredhin nëpër institucione dhe të humbin kohë, u përmendën harmonizimet me ligjet tjera, u përmendën tantiebat nga KEK-u, dhe vetëm KEK-u i përmendi tantiebat. U përmend nga disa diskutues që distanca e shfrytëzimit të rregullohen me ligj, varësisht nga veprimtaria minerare dhe specifikat e atyre veprimtarive minerare, qoftë të linjtit, qoftë guroret apo diçka tjetër që është e domosdoshme të futet në ligj.

Doli së fundi edhe nevoja që të plotësohet dhe ndryshohet ligji dhe gjithsesi të rregullohet me ligj hidrokarburet e lëngëta dhe të gazta, sepse të ngurrtat janë të rregulluara. U përmend në këtë debat publik, që për mua ishte interesante, trajtimi i kompanive të mëdha që merren me operime minerare të rregullohet me dispozita të veçanta, ndryshe nga veprimtaritë tjera të vogla minerare.

Së fundi, ju falënderoj shumë për pjesëmarrje në këtë dëgjim publik. Ne do të jemi vazhdimisht me ju dhe do të vazhdojmë me monitorimin e ligjit, e sigurisht se do të dalim t'i vizitojmë edhe kompanitë tuaja që jeni këtu, por edhe të tjera që t'i shohim për së afërmi dhe më në detale ato shqetësimet tjera.

Edhe njëherë, ju përsëndes! Ju falënderoj shumë dhe të gjitha t'mirat, suksese kudo që jeni.